



Vëllimi 3, Numri 4

Mars 2022

# BULETINI KUNDËR TERRORIZMIT

PËR BALLKANIN, RRETH BALLKANIT

## NË KËTË NUMËR

Lajme dhe Informacione kundër terrorizmit 1

Arrestohet shtetasi serb si i dyshuar për mbështetje të ISIS - 2

Kosova dënon katër luftëtarë të huaj terroristë të riatdhesuar në korrik 2021 - 2

Përdorimi i internetit për qëllime terroriste: Një raport i ri nga njësia e OKB Teknologjia kundër Terrorizmit - 2

Aftësitë e intervistimit: Bazat-3

## Lajme dhe informacione lidhur me terrorizimin për përditësimin dhe komunikimin mes partnerëve tanë në rajon

*Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ndihmës Zhvillimore dhe Trajnimit Prokurorial (OPDAT) në partneritet me Departamentin Amerikan të e Shtetit, Byroja e Antiterrorizmit*

Ky numër i buletinit sjell lajme për procedimet e suksesshme penale të LHT-ve në Kosovë dhe për arrestimin e fundit të një të dyshuari terrorist në Serbi. Raportohet, gjithashtu, mbi përdorimin e internetit për qëllime të shpërndarjes së propagandës. Në fund, vazhdohet me serinë e këshillave praktike për intervistimin e të dyshuarve.

Tom Saunders  
Këshilltar Ligjor kundër Terrorizmit  
për Ballkanin  
OPDAT/DOJ  
Ambasada e SHBA, Sarajevë  
[SaundersTN@state.gov](mailto:SaundersTN@state.gov)

Clay Stiffler  
Këshilltar Ligjor kundër Terrorizmit  
për Ballkanin  
OPDAT/DOJ  
Ambasada e SHBA, Tiranë  
[StifflerRC@state.gov](mailto:StifflerRC@state.gov)

Jasenka Ferizović, Këshilltare Ligjore  
OPDAT/DOJ  
Ambasada e SHBA, Sarajevë  
[FerizovicJ@state.gov](mailto:FerizovicJ@state.gov)

Bledar Bashanović, Specialist Ligjor  
OPDAT/DOJ  
Ambasada e SHBA, Tiranë  
[BashanovicB@state.gov](mailto:BashanovicB@state.gov)

# Arrestohet shtetasi serb si i dyshuar për mbështetje të ISIS

Në shkurt 2022, autoritetet serbe arrestuan Igor Despotovic, i cili dyshohet se ka kërkuar mbështetje për ISIS në mediat sociale. Sipas Gjykatës së Lartë të Beogradit, Despotovic ka hapur dhe ka administruar llogari të shumta në mediat sociale përmes të cilave ka ndarë publikisht tekste, regjistrime dhe fotografi, duke glorifikuar ISIS-in dhe “duke promovuar aktet e kësaj organizate, duke bërë thirrje për ndihmë materiale dhe për bashkim me të, me luftën e armatosur, dhunën dhe me sulmet vetëvrasëse.” Despotovic po mbahet për 30 ditë në paraburgim ndërkohë që hetimi vazhdon.

Deri më sot, në Serbi janë ndjekur penalisht 7 persona për vepra penale që lidhen me terrorizmin. Të shtatë këta të pandehur janë dënuar me burg nga shtatë vjet e gjysmë deri në 11 vjet. Përveç kësaj, dhjetëra të tjerë kanë marrë vendime ende të paekzekutuara për pjesëmarrjen në luftime në Ukrainë. (Këto raste që lidhen me Ukrainën janë shënuar që në 20 shkurt 2022, pra para se të fillonte konflikti.)

**Burimi:** [Serbia arreston një shtetas të dyshuar për ‘glorifikimin’ e Shtetit Islamik](#)

## Kosova dënon katër luftëtarë terroristë të riatdhësuar në korrik 2021

Në muajin janar, Departamenti i Posaçëm i Gjykatës së Shkallës së Parë të Prishtinës dënoi katër LHT për organizimin dhe pjesëmarrjen në një grup terrorist për rolin që kishin luajtur në udhëtimin për në Siri dhe për pjesëmarrjen në luftime për ISIS-in.

Fidan Demolli, Sadri Nerjovaj, Skender Qerimi dhe Kujtim Dacaj ishin riatdhësuar në Kosovë nga Siria në korrik të vitit të kaluar dhe secili e kishte pranuar fajësinë. Demolli u dënua me dy vjet e gjashtë muaj burg për pjesëmarrjen në ISIS në vitin 2014 dhe për angazhimin e tij si luftëtar dhe roje deri në momentin e kapjes nga Forcat Demokratike Siriane në vitin 2019. Dacaj e kishte pranuar se kishte udhëtuar për në Siri bashkë me bashkëshorten dhe vajzën e tij në vitin 2014 për t’u bërë pjesë e ISIS-it dhe për të shërbyer si luftëtar dhe si instruktor për snajperët. Ai u dënua me tre vjet e tetë muaj burg. Nerjovaj dhe Qerimi u dënuan secili me tre vjet e gjashtë muaj burg.

Dy LHT të tjerë, të cilët ishin riatdhësuar në muajin korrik, janë duke u gjykuar aktualisht për akuza të ngjashme.

DoJ/OPDAT kanë asistuar në riatdhësimin e LHT-ve, kanë ndihmuar në marrjen e provave nga fusha e betejës që janë përdorur për dënimin e tyre, si dhe e kanë ndihmuar Kosovën për marrjen e ndihmës ligjore reciproke në mënyrë që provat e marra të mund të përdoren në gjykatë.

**Burimet:** [Dënohet me 3 vite e 3 muaj burg për pjesëmarrje në luftërat e ISIS-it dhe angazhim në Batalionin e Snajperistëve](#)

[Pranoi se luftoi për ISIS-in, dënohet me 2 vite e 6 muaj burgim i akuzuari për terrorizëm](#)

[I akuzuari për terrorizëm dënohet me 3 vite e tetë muaj burgim, akuzohet se ishte trajner i snajperistëve në ISIS](#)

[Dënohet me 3 vjet e 6 muaj burgim i akuzuari për pjesëmarrje në ISIS](#)

## Përdorimi i internetit për qëllime terroriste:

### Një raport i ri nga njësia Teknologjia kundër Terrorizmit e Kombeve të Bashkuara

Qeveritë që luftojnë kundër përdorimit të internetit për qëllime terroriste fokusohen shpesh tek kompanitë tradicionale të mediave sociale si Facebook (tashmë Meta), Youtube.com, dhe Twitter. Por, megjithëse mediat sociale mbeten mjet i fuqishëm për terroristët dhe për grupe të tjera të dhunshme ekstremiste, këto grupe krijojnë dhe operojnë gjithashtu faqet e tyre të internetit, duke anashkaluar në këtë mënyrë mbikëqyrjen e kompanive tradicionale. Sipas një raporti të ri, faqet e internetit të përdorura nga terroristët dhe nga ekstremistët e dhunshëm (T/VEOW) “përbëjnë një nga kërcënimet më të rëndësishme ndaj përpjekjeve globale në adresimin e përdorimit të internetit për qëllime terroriste”

Teknologjia kundër Terrorizmit (TAT) është një grup ekspertësh dhe zhvilluesish kundër terrorizmit që punon me industrinë e teknologjisë “për të adresuar përdorimin e internetit për qëllimet terroriste, duke respektuar në të

njëjtën kohë të drejtat e njeriut”, sipas faqes së internetit të këtij grupi. Në muajin janar, TAT publikoi raportin *Kërcënime nga faqet e internetit të operuara nga terroristët dhe ekstremistët e dhunshëm*, ku pretendohet se qeveritë dhe studiuesit nuk kanë arritur të fokusohen sa duhet te kërcënimet që paraqet T/VEOW.

T/VEOW përdoren kryesisht për shpërndarjen dhe për arkivimin e propagandës, për rekrutimin e anëtarëve të rinj, si dhe për t’u dhënë mundësinë anëtarëve ekzistues që të komunikojnë brendapërbrenda. Duke filluar nga janari 2021, TAT ka identifikuar 198 faqe interneti që TAT vlerëson se operohen nga terroristë dhe ekstremistë të dhunshëm që përbëjnë një kërcënim të besueshëm dhe urgjent ndaj shoqërisë.

“Fakti që terroristët dhe ekstremistët e dhunshëm janë në gjendje të operojnë qindra faqe interneti që tërheqin miliona shikime, pa qenë objekt i asnjë lloji dënimi, përbën një dështim të sektorit global online kundër terrorizmit,” shprehet Adam Hadley, themeluesi i TAT. “Faqet e internetit të operuara nga terroristët [përbëjnë] një kërcënim kryesor strategjik sa i përket përdorimit të internetit për qëllime terroriste.”

Për adresimin e këtij kërcënimi raporti i TAT ofron disa rekomandime për qeveritë, për ofruesit e infrastrukturës së internetit dhe për studiuesit/shoqërinë civile. Për qeveritë,

katër rekomandimet e TAT janë:

- Konsiderimi si prioritet i T/VEOW në diskutimet e politikave të ndryshme në lidhje me përdorimin e internetit për qëllime terroriste;
- Hartimi i “një strategjie globale për zbutjen e rrezikut” në luftën ndaj T/VEOW, duke përfshirë edhe koordinimin me shtete të tjera në bazë të shtetit të së drejtës;
- Marrja e masave për luftën ndaj T/VEOW “duke respektuar plotësisht të drejtat e njeriut”, duke përfshirë lirinë e shprehjes; dhe
- Ofrimi i udhëzimeve të qarta për të përcaktuar se kush duhet të shpallet grup terrorist, pasi të pasurit e udhëzimeve të qarta e bën më të lehtë sigurimin e bashkëpunimit nga ana e kompanive teknologjike për ndërprerjen e operimit të këtyre faqeve interneti.

TAT punon me sektorin e teknologjisë për identifikimin e faqeve të internetit me përmbajtje që lidhet me terrorizmin. Në momentin që autoritetet identifikojnë se një faqe e

caktuar interneti operohet nga një grup terrorist, ato mund të ndërmarrin një sërë masash, si p.sh. të punojnë me Regjistrin e DNS për t'i bërë ato faqe interneti të paaksesueshme për publikun ose mund të punojnë me motorët e mëdhenj të kërkimit për “t'i hequr nga lista” ato faqe dhe për ta bërë më të vështirë financimin e tyre.

Çdo përpjekje e qeverive për të hequr nga lista e kërkimit apo për të bërë jofunksionale faqe të caktuara interneti shoqërohet me shqetësime për lirinë e fjalës dhe të shprehjes. TAT thekson se “masat ndaj faqeve të dyshuara të T/VEOW duhet të merren vetëm pasi të jetë vërtetuar qëllimi i këtyre faqeve dhe pasi të jetë arritur standardi i lartë sa i përket pranueshmërisë së provave.” Provat për aktivitetin kriminal duhet të jenë të qarta dhe të mbështeten me evidenca të mjaftueshme për shmangien e cenimit nga ana e qeverisë të lirisë së shprehjes.

**Burime:** [Kërcënimet nga faqet e internetit të operuara nga terroristët dhe ekstremistët e dhunshëm](#)

## Këshilla praktike

### Aftësitë e intervistimit: Bazat

Në numrin e fundit të këtij buletini, ju prezantuam me tetë hapat e një interviste të suksesshme. Megjithatë, të kuptuarit e këtyre hapave përbën vetëm fillimin. Në cilësinë dhe në sasinë e informacioneve që marrim nga intervistat ndikojnë një sërë faktorësh dhe hetuesit duhet të kenë një sërë aftësish dhe teknikash që të ndihmojnë për të pasur intervista të suksesshme. Në këtë numër, ju prezantojmë disa prej këtyre aftësive dhe teknikave, sidomos ato që përdoren më shpesh dhe që janë më thelbësoret.

**Mënyrat e sjelljes.** Hetuesit e mirë duhet ta kenë gjithmonë nën kontroll dhe ta “dominojnë situatën”. Megjithatë, ky lloj dominimi vështirë të arrihet duke qenë arrogant, pasi arroganca krijon armiqësi tek shumica e personave të intervistuar, pavarësisht nëse janë apo jo fajtorë. Dhe, nëse edhe hetuesi i përgjigjet armiqësisë duke u bërë edhe më arrogant, siç ndodh me shumë oficerë të zbatimit të ligjit, konfrontimi bëhet i pashmangshëm. Hetuesit duhet të mos harrojnë se të qenit komodë pa qenë arrogantë, tregojnë një lloj dominimi: “Është sjellja, dhe jo fjalët ato që përcaktojnë se kush e dominon situatën. Një intervistues i mirë e di se njerëz dominantë janë ata që dinë të sillen dhe që janë të sigurt në vetvete.”

**Informimi mbi të drejtat.** Hetuesit duhet të veprojnë gjithmonë në përputhje me çdo detyrim ligjor brenda juridiksionit të tyre, duke ua bërë të ditur personave që intervistojnë të drejtat e tyre. Megjithatë, hetuesit duhet të bëjnë në të njëjtën kohë maksimumin për të shmangur “efektet frikësuese” që mund të sjellë kjo. Për ta arritur këtë, hetuesit nuk duhet ta shohin informimin mbi të drejtat si një pengesë dhe duhet të fillojnë që ta shohin atë si një mënyrë për arritjen e qëllimit, zbulimin e së vërtetës. Hetuesit e mirë e përdorin informimin e detyrueshëm për t'i dërguar personit që intervistojnë mesazhin se ai është person i besueshëm dhe se duhet të luajë ndershmëri për krijimin dhe për forcimin e një procesi ndërtimi marrëdhëniesh mes tyre.

**Mbajtja e shënimeve.** Megjithëse mbajtja e shënimeve gjatë intervistave është e rëndësishme, kjo mund edhe të krijojë ndërprerje për bisedën, duke shkaktuar pauza të gjata ndërkohë që hetuesi shkruan, duke i zvogëluar mundësitë e hetuesit për ta vëzhguar personin që po interviston dhe duke e bërë personin e intervistuar që t'i peshojë fjalët me më shumë kujdes. Për këtë arsye, hetuesit duhet të kujdesen që mbajtja e shënimeve të mos cenojë rrjedhën e intervistës.

**Të dëgjuarit.** Të dëgjuarit efektiv është teknika më e rëndësishme në të gjithë procesin e intervistimit, sepse “ajo çka pyetet dhe ajo çka thuhet nuk janë gjërat më të rëndësishme; gjithë rëndësia qëndron tek ajo çka dëgjohet dhe ajo çka kuptohet.” Hetuesit duhet të mos harrojnë se të dëgjuarit është një proces aktiv që varet nga përfshirja mendore: “Ne dëgjojmë më shumë me tru sesa me vesh.” Megjithëse përqendrimi luan një rol kyç në këtë proces, ka edhe disa teknika specifike që mund të ndihmojnë hetuesit të rrisin aftësitë e tyre të të dëgjuarit. Këtu përfshihen: 1) ofrimi i treguesve joverbalë të të dëgjuarit (si p.sh. pohimi me kokë), 2) perifraximi herë pas here i asaj çfarë ka thënë personi i intervistuar dhe 3) mosdalja në gjykime ose të paktën mosshfaqja e gjykimeve apo perfundimeve para kohe.

**Burimi:** John E. Hess, *Intervistimi dhe Marrja në pyetje nga forcat e zbatimit të ligjit*, Botimi i dytë, Anderson Publishing (2010)